



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:024188

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05487072

**C.nr.429/22**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN **Departamenti i përgjithshëm** Divizioni civil, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridiko kontestimore të paditëses F.L. dhe A.S. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat M.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, vlera e kontestit 640 euro, jashtë seance, me datë **21.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.L. dhe A.S. nga Prizreni
- II. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses F.L. në emer të kompensimit të shujtave ditore, të i'a paguaj shumën prej 320 euro, (160x2), dhe paditëses A.S. në emer të kompensimit të shujtave ditore, të i'a paguaj shumën prej 320 euro, (160x2), me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie 08.02.2022, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
- III. **DETYROHET** e paditura që paditëses t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditëset F.L. dhe A.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij avokat M.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 08.02.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt kontesti kompensim i ushqimit në punë.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se paditëset F.L. dhe A.S. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në Sh.M.L.P "Ymer Prizreni" dhe se të njëjtave u takon kompensimi për shujtat ditore që nga viti 2020, nga 2 euro në ditë për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur vullnetarisht detyrimin që ka ndaj paditëses, i ka propozuar gjykatës që të

merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 20.03.2024, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që paditësve të i kompensohen shujtat ditore nga data 01.10.2020 e deri me datë 30.06.2021 për 160 ditë pune, në lartësi prej 320 euro.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës si të pa bazuar, duke kërkuar që Gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar duke e marrë për bazë njoftimin e MASHTI-tit nr.01B/488 të dt.21.11.2022 për shkëputjen e kontratës kolektive të dt 22.01.2021. Ka theksuar se pretendimi i paditësës se u takon kompensimi i shujtave është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 i Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit SBASHK-ut, ndërsa Paditëset nuk kanë paraqitur fakte se është anëtar e kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se Paditësja kanë ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative dhe me këtë veprim Komunës së Prizrenit i shkakton shpenzime të mëdha sepse obligohet edhe në shpenzimet e procedurës. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura thirret në atë se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e Paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e Paditësja është e themeltë, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në Sh.M.L.P “Ymer Prizreni” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 408/22 të datës 01.07.2021 të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F.L. dhe A.S. janë në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe të njëjtat në vitin 2020-2021 për periudhën nga data 01.10.2020 e deri më 30.06.2021 kanë punuar gjithsej 160 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021 është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (antarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...*”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*”, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që Paditësja si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit me numër 01/B, numër të prot. 105 e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditëset F.L. dhe A.S. kërkesa është bërë e arritshme për 160 ditë pune për vitin 2020-2021, apo shuma e përgjithshme prej 320,00 (treqind e njëzet) euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (08.02.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritior.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 (njëqind e njëzet e katër) euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.429/22 më datë 21.03.2024**

**G j y q t a r j a**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.